



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.50, datë 31.07.2018

PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES MIDIS ALBTELECOM SH.A DHE VODAFONE ALBANIA SH.A”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 31.07.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, datë 11.06.2010 shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përfundimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronjat a,b,n të nenit 8, neni 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);

2. Pika 1 e nenit 41, pika 2 e nenit 79, neni 44, pika 1 e nenit 23, neni 16, neni 5, neni 82, neni 87, neni 14, neni 81, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
3. Shkronja e, pika 10 e nenit 5 dhe neni 15, i Rregullores së AKEP nr. 19, datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, Datë 14.06.2010, ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1373, Datë 10.09.2010 e ndryshuar;
4. Rregullore e AKEP nr. 18, datë 11.06.2010 për “Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, Datë 11.06.2010.
5. Pika p, e nenit 19 të Rregullores së “Brendshme per funksionimin e Keshillit Drejtues”, miratuar me Vendim nr.7, datë 16.02.2017 të Keshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendim Nr.44, datë 19.6.2018 Për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.”;
- Shkresë e sipërmarrësit Altelecom Sh.a nr. 5437 Prot, datë 25.05.2018 (nr.1715 Prot. i AKEP, datë 28.05.2018), “Mbi praktikën abuzive të përsëritur të “sim box-eve” të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit Altelekom”.
- Bashkëngjitur shkresës së sipërmarrësit Altelecom Sha nr. 5437 Prot, datë 25.05.2018 (nr.1715 Prot. i AKEP, datë 28.05.2018) edhe një CD e cila përmban:
 - o Komunikim elektronik (emaile) të skuadrës antifraud të AT drejtuar skuadrës antifraud të Vodafone (2016-2017-2018);
 - o Korrespondenca elektronike (emaile) ndërmjet skuadrave respektive të menaxherëve të interkoneksionit (2016-2017-2018);
 - o “File” të numrave (CLI-ve) të dedukuara nga teste të by-pass-it të thirrjeve/trafikut ndërkombëtar. (2016-2017-2018);
 - o Përmbledhje e të gjithë trafikut nga këto CLI sipas muajve (2016-2017-2018).
- Shkresë e sipërmarrësit Altelecom sh.a. me nr. 5437/1 Prot. datë 03.07.2018 (nr.1615/5 Prot. datë 03.07.2018 i AKEP), “Ne vllim të Vendimit nr. 44 dt. 19.06.2018 per “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.”;
- Bashkëngjitur shkresës së sipërmarrësit Altelecom sh.a. nr. 5437/1 Prot. datë 03.07.2018 (nr.1615/5 Prot. datë 03.07.2018 i AKEP), gjithashtu një “Tabelë përmbledhese e trafikut të realizuar nga CLI-të e zbuluara-trafik ndërkombëtar” e përditesuar me informacionin e trafikut për muajin Maj dhe Qershor 2018;
- Shkresë e Sipërmarrësit Vodafone sh.a me Ref. LEA/060/IL, datë 06.07.2018 (protokolluar ne AKEP me nr.1615/6 Prot. Datë 09.07.2018 i AKEP), “Mbi vendimin

- e Këshillit Drejtues për fllimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a;
- Shkresë e sipërmarrësit Vodafone sh.a, me Ref. LEA/064/IL, (protokolluar ne AKEP me nr.1615/10 Prot. Datë 17.07.2018 i AKEP), “Mbi vendimin e Këshillit Drejtues për fllimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a;
- Shkresë nr 1615/7, datë 10.07.2018 “Mbi kërkesën e Vodafone sh.a për t’i vënë në dispozicion të dokumentacionit lidhur me “Procedurën administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”;
- Procesverbal i mbajtur gjatë takimit me palët datë 12.07.2018, ora 14.00 pranë ambienteve të AKEP;
- Raport Përmbledhës

si dhe nga konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje, fakteve të paraqitura e analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP bazuar në kërkesën e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a me nr.5437 Prot. datë 25.05.2018 (nr.1615 Prot. Datë 28.05.2018 i AKEP), bazuar në pikën 1 të nenit 41 dhe nenin 44 të ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjermës në të nenit 8 dhe neni 120 të ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 për “Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe pikës 7.3 të nenit 7 të Rregullores nr 18, datë 11.06.2010, me anë të Vendimit Nr.44, datë 19.6.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, vendosi fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke i’u kërkuar palëve që brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren Nr. 18 datë 11.06.2010 të depozitojnë pretendimet e tyre në lidhje me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

2. Sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.” me shkresën nr. 5437/1 Prot. datë 03.07.2018 (nr.1615/5 Prot. datë 03.07.2018 i AKEP), ka ritheksuar edhe një herë pretendimet e tij të shprehura edhe në shkresën fillestare me nr.5437 Prot. datë 25.05.2018 (nr.1615 Prot. datë 28.05.2018 i AKEP), duke argumentuar ndër të tjera si vijon:

- *Trafiku nga praktikat sim box vijon ende në volume të konisderueshme nga “Vodafone Albania sh.a.” edhe për muajt Maj dhe Qershor 2018.*
- *Gjithashtu, Albtelecom shpreh se se skuadrat anti-fraud vazhdojnë të raportojnë rregullisht tek “Vodafone Albania sh.a.” për CLI-të e zbuluara nga ana tyre, por nga “Vodafone Albania sh.a.” nuk shohin të jetë marrë asnjë veprim konkret për parandalimin dhe ndalimin e kësaj praktike, ndërkohë që dëmi financiar nga aktiviteti i sim box-ve vijon të thellohet për sipërmarrësin “Albtelecom sh.a”.*

Për sa më sipër, “Albtelecom sh.a.”, ka paraqitur në cilësinë e provës materialet si më poshtë:

- *Tabelat përmbledhëse e trafikut të realizuar nga CLI-të e zbuluara- trafik ndërkombëtar;*
- *Përshkrim i përmbajtjes së CD-së (periudha Maj-Qershor 2018);*
- *CD me “files” (dokumente) të referuar në këtë shkresë dhe sipas përshkrimit bashkëngjitur.*

Në përfundim, “Albtelecom sh.a.” kërkon nga AKEP që në mbyllje të këtij procedimi administrativ, të detyroje me aktin përkatës vendimarrës, operatorin “Vodafone Albania sh.a.” për:

1. Marrjen e masave konkrete për ndalimin e menjëhershëm dhe bllokimin e këtij lloj trafiku dhe marrjen e masave për parandalimin e përsëritjes së rasteve të ngjashme në të ardhmen;

2. Të kompensoje dëmin financiar të trafikut në shkelje në referim të MI dhe Rregullores për Akses dhe Interkoneksion, për të gjitha CLI-të e njoftuara palës Vodafone (për dijeni edhe AKEP) si “praktika simbox-i”, trafiku i realizuar nga këto CLI drejt rrjetit ALBtelecom, për periudhen të pakten nga Janari 2016 e në vijim, për të cilën do të faturohet sipas natyrës reale të këtij trafiku, - trafik ndërkombëtar.

3. Sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”, me shkresën Ref. LEA/060/IL, datë 06.07.2018 (Nr.1615/6 Prot. Datë 09.07.2018 i AKEP), ka depozituar pretendimet e tij, duke argumentuar ndër të tjera si vijon:

-Vodafone shprehet se aktiviteti i Sim-box-ve është një fenomen i njohur botërisht dhe që ndodh tek të tre operatorët në treg. Ndalimi i ri-rrugezimit të paligjshëm të trafikut është një sfidë e përbashkët dhe objektiv që e ndajnë të gjithë operatorët në treg padallim, ndaj kanë qënë përherë të gatshëm për të çuar dhe më tej nivelin e bashkëpunimit për adresimin dhe zgjidhjen korrekte të këtij fenomeni. Sipas Vodafone aktiviteti i SIM Box-eve, kryhet nëpërmjet një skeme të caktuar pa dyshim, pa dijeninë e operatorëve.

-Vodafone ka sjellë në vëmendje masat konkrete të ndërmarra prej tij me qëllim minimizimin e këtij trafiku, si më poshtë:

- *Janë dyfishuar numri i testeve nga kompanitë e kontraktuara nga “Vodafone Albania sh.a.” për detektimin dhe monitorimin e trafikut ri-rrugëzuar në mënyre abuzive;*
- *Është vendosur të hiqet nga tregu paketa për lidhje me vlerë 200 Leke duke ofruar tashmë në treg si paketën më të lirë atë me 500 Lekë. Paketa ditore, e cila është paketa më e përdorur nga numrat që kryejnë këtë ri-rrugezim trafiku (80%), është ndryshuar nga 70 lekë në 100 lekë.*
- *Është ndryshuar politika tregtare në raport me komisionet duke rritur dhe vështirësuar kriteret që kualifikojnë pikat e shitjeve për të përfituar komisione. Konkretisht, në mënyre që të kualifikohesh për të përfituar komision duhet të*

aktivizosh një paketë me vlerë minimale 800 lekë, pra praktikisht në mënyrë që të përfitojnë nga komisionet pikat e shitjeve duhet të aktivizojnë vetëm paketa standarte mujore. Siç është shprehur dhe më sipër, personat që ushtrojnë aktivitet Sim boxi nuk aktivizojnë paketa mujore, por ditore. Kjo masë dekurajon pikat e shitjeve që të “implikohen” në ndonjë formë me këtë aktivitet;

- Janë shtuar rregulla strikte dhe penaltete në lidhje me regjistrimet me gabime, ku në fakt ky lloj aktiviteti gjen maskim (si mjet identifikimi përdoret vetëm numri personal ID në përputhje dhe me kërkesat e portabilitetit).
- Janë forcuar gjithashtu rregullat e verifikimit (vetting), duke konstatuar parregullsitë në regjistrim dhe ndaluar aktivizimin e numrave. Në këtë kuadër, për çdo regjistrim gabim do të ketë penaltete financiare për kosto shtesë në lidhje me verifikimin. Konkretisht, janë paralajmëruar dhe më pas janë mbyllur pika shitje që janë konstatuaraktivizimi i numrave që kanë kryer aktivitet sim box (mbi 20 pika);
- Eshte kufizuar numri i kartave që jepen në përdorim për pajtimtar nga 20 në 5.
- “Vodafone Albania sh.a.” vijon duke thënë se duhet mbajtur në vëmendje se çdo ndërhyrje duhet të jetë e bazuar në evidenca të pakundërshtueshme që garantojnë se shkelja është kryer dhe se (duke ju referuar pretendimeve të “Albtelecom sh.a.”) trafiku i ri-rrugëzuar është domosdoshmërisht trafik ndërkombëtar, gjë që “Vodafone Albania sh.a.” nuk mund ta konfirmojë plotësisht kur bëhet fjale për CLI të modifikuar nga të tretet.
- Vodafone granton se në çdo rast nuk ka cënuar asnjë dispozitë të Marreveshjes se Interkoneksionit mes palëve, apo të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi që zbatohen përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare. Pretendimet e “Albtelecom sh.a.” sipas “Vodafone Albania sh.a.” nuk qëndrojnë, janë të pabazuara në prova dhe janë jashtë objektit të Rregullores nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” si dhe fushës së veprimit e rolit të AKEP në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- Gjithashtu me këtë shkresë Vodafone ngre pretendimin se, AKEP në përputhje me parashikimet e Rregullores nr.18, datë 11.06.2010, si dhe duke marrë parasysh që aktiviteti i SIM-box-eve nuk kryhet nga vetë operatorët dhe nuk ka një parashikim rregullator për adresimin e tij, nuk duhet ta kishte pranuar këtë kërkesë për fillimin e procedimit administrativ.

Në përfundim të këtij procedimi administrativ, “Vodafone Albania sh.a.” kërkon nga AKEP:

1. Të rrëzojë kërkesën e “Albtelecom sh.a.” për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me pretendimet e shkeljes së detyrimeve për identifikimin dhe mos modifikimin/fshehjen e numrit thirrës që buron nga Marreveshja dhe Rregullorja për Akses dhe Interkoneksion,

2.Në zbatim të nenit 5/9,d) të Rregullores ku parashikohet që “Operatori që pretendon shkeljen është përgjegjës nëse pretendimet e tij për shkelje nuk vërtetojnë shkeljen e pretenduar. Në një rast të tillë AKEP me vendim të arsyetuar mban qëndrim dhe vendos masa administrative kundrejt këtij operatori” të marri masat përkatëse ndaj “Albtelecom sh.a.” për kërkesën në abuzim me të drejtën që i njeht kuadri rregullator në fuqi.

4. Këshillit Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr.44, datë 19.6.2018, në bazë të pikës 2 të nenit 79 të ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe paragrafit të dytë të pikës 7.3 të Rregullores Nr.18, datë 11.06.2010, ka ngritur Komisionin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes (KZM) me qëllim delegimin e veprimeve të hetimit administrativ për procedurën administrative në fjalë në respektim të parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. KZM, në analizë të provave dhe rrethanave që paraqet çështja në fjalë, ka vlerësuar së pari kompetencën e AKEP për shqyrtimin e mosmarrëveshjes. Konkretisht, në mbështetje të nenit 120, të ligjit 9918/2008, gjermës e) të pikës 10 të nenit 5 dhe nenit 15 të Rregullores nr.19, datë 14.06.2010, “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, si dhe neni 5 i Rregullores nr.18, datë 11.06.2010, “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, çështja e paraqitur nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a.” me kërkesën nr. 5437 Prot. datë 25.05.2018, plotëson të gjitha kushtet formale për të marrë në shqyrtim procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Përsa i takon kërkesës së parë të “Albtelecom sh.a.” për: “Marrjen e masave konkrete për ndalimin e menjëhershëm dhe bllokimin e këtij lloji trafiku dhe marrjen e masave për parandalimin e përsëritjes së rasteve të ngjashme në të ardhmen”, KZM vlerëson se AKEP ka kompetencë për të gjykuar mbi këtë kërkesë bazuar në legjislacionin e sipërcituar.

Lidhur me kërkesën e dytë të Albtelecom: “Vodafone Albania sh.a. të kompensojë dëmin financiar të trafikut në shkelje në referim të MI dhe Rregullores për Akses dhe Interkoneksion, për të gjitha CLI-të e njoftuara palës Vodafone (për dijeni edhe AKEP) si "praktika simbox-i", trafiku i realizuar nga këto CLI drejt rrjetit ALBtelecom, për periudhën të pakten nga Janari 2016 e në vijim, për të cilën do të faturohet sipas natyrës reale të këtij trafiku, - trafik ndërkombëtar”; shprehemi se kjo kërkesë del jashtë kompetencave të AKEP të parashikuara në ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008 për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore për zbatim të tij.

Detyrimet civile për shpërblim të dëmit lindin sikurse nga shkaktimi i dëmit, po ashtu edhe nga shkelja e kontratës të parashikuara dhe rregulluara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Si e tillë e drejta për shpërblimin e dëmit realizohet kryesisht në procedurë gjyqësore dhe jo administrative. AKEP si person juridik, publik, i pavarur, pjesë e administratës publike ushtron veprimtari brenda Juridiksionit administrativ dhe nuk mund të marrë vendime të cilat lidhen me një marrëdhënie juridiko-civile, të krijuar midis dy subjekteve privatë. Pavarësisht tagrit që i ka dhënë ligji 9918, datë 19.5.2008, të ndryshuar, për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të

komunikimeve elektronike AKEP ka një fushë veprimi mjaft të kufizuar dhe specifike, që përjashton zgjidhjen e kërkesës në fjalë.

Si përfundim, në kushtet kur *një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij*” (neni 16 Ligji nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”), AKEP do të shprehet vetëm për kërkesën e parë të Albtelecom sh.a.

5. Lidhur me kërkesën e sipërmarrësit Vodafone Albania: *Në zbatim të nenit 5/9,d) të Rregullores ku parashikohet që “Operatori që pretendon shkeljen është përgjegjës nëse pretendimet e tij për shkelje nuk vërtetohen shkeljen e pretenduar. Në një rast të tillë AKEP me vendim të arsyetuar mban qëndrim dhe vendos masa administrative kundrejt këtij operatori” të marri masat përkatëse ndaj “Albtelecom sh.a.” për kërkesën në abuzim me të drejtën që i njeh kuadri rregullator në fuqi*; shprehemi se parashikimet e pikave 9 dhe 10 të nenit 5, të Rregullores nr. 19, datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin do të ishin të zbatueshme në rastin kur modifikimi apo fshehja e CLI të thirrjeve të përcjella bëhet nga njëri operator tek tjetri dhe jo në rastet kur modifikimi apo fshehja e CLI, bëhet për shkak të veprimeve abuzive nga palë të treta.

Për më tepër sipas pretendimeve dhe provave të sjella nga sipërmarrësi Albtelecom nëpërmjet shkresës nr. 5437/1 Prot. datë 03.07.2018 (nr.1615/5 Prot. datë 03.07.2018 i AKEP), kjo procedurë ka filluar që në vitin 2016 dhe nuk ka vijuar sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara qartë në pikën 9 dhe 10 të nenit 5 të Rregullores nr. 19, datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar.

KZM bazuar në të dhënat dhe provat që i janë vënë në dispozicion e ka të pamundur të evidentojë burimin e gjenerimit të kësaj praktike (sim box) dhe në kushtet kur nuk janë respektuar hapat dhe afatet që duhet të ndiqen nga sipërmarrësit sipas përcaktimeve të pikës 9 dhe 10 të nenit 5 të Rregullores së sipërcituar, AKEP nuk mund të zbatojë masa administrative kundrejt asnjërit prej dy sipërmarrësve.

6. Në zbatim të neneve 14, 81, 82 të “Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KZM ka marrë në konsideratë dhe i ka dhënë rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me mosmarrëveshjen. KZM ka çmuar, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Nga provat e vëna në dispozicion të AKEP bashkëlidhur me shkresën nr. 5437 Prot. datë 25.05.2018 (nr.1615 Prot. Datë 28.05.2018 i AKEP) dhe shkresën nr 5437/1 Prot (nr 1615/5 Prot, datë 03.07.2018 i AKEP) rezulton se ka modifikim të CLI. Prej muajit qershor është verifikuar se trafiku i gjeneruar prej këtij fenomeni ka patur një ulje të ndjeshme nga ana e sipërmarrësit Vodafone, kjo falë edhe adresimit të çështjes pranë AKEP. Gjithsesi minimizmi i fenomenit mbetet ende një sfidë për sipërmarrësin Vodafone Albania.

Për sa më sipër në bazë të provave të paraqitura nga Altelecom për fenomenin e anashkalimit të trafikut ndërkombëtar në kombëtar nëpërmjet praktikave “sim box”, Sipërmarrësi Vodafone duhet të marrë masa të mëtijshme konkrete për minimizimin dhe parandalimin në të ardhmen në zbatim të parashikimeve të Marrëveshjes së Interkoneksionit midis dy palëve, pasi çdo ndryshim/modifikim apo fshehje e identitetit të numrit thirrës përben një shkelje të marrëveshjes në fjalë si dhe shkelje ligjore (5.2.8 MI).

Në këtë kuptim sipërmarrësi Vodafone Albania në bazë të pikës 18.2 të MI, **duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e çdo rritjeje artificiale të trafikut kombëtar për shkak të veprimeve abuzive nga palë të treta, dhe të bashkëpunojë me Altelecom për shkëmbimin e informacionit në lidhje me masat e caktuara për parandalimin e shfaqjes së abuzimeve të tilla në rrjetet përkatëse të palëve dhe eliminimin e tyre.**

- Vodafone duhet të marrë të gjitha masat teknike dhe ligjore për parandalimin e fenomenit abuziv të anashkalimit të trafikut ndërkombëtar në kombëtar nëpërmjet praktikave Simbox nga palët e treta, nga rrjeti Vodafone Albania drejt rrjetit mobile dhe fiks të Altelecom.
- Për thirrjet e gjeneruara nga rrjeti Vodafone Albania dhe të përcjelle tek Altelecom, Vodafone duhet të përcjellë gjithmonë CLI e cila do të jetë në formën +355+NDC+SN ku NDC është Kodi i Drejtimit Kombëtar dhe SN është numri i përdoruesit thirrës. CLI do t'i prezantohet rrjetit Altelecom dhe për thirrjet që mund të tranzitohen rregullisht nga rrjeti Vodafone Albania dhe të përcjella për terminim në rrjetin Altelecom, përfshirë edhe ato të pajtimtarëve të portuar në rrjetin Vodafone Albania.
- Vodafone duhet të garantojë rrugëzimin transparent të informacionit të identitetit të numrit thirrës, pa e ndryshuar, modifikuar ose fshehur, përmes rrjetit të saj dhe dërgimin e identitetit të numrit thirrës në rrjetin e palës tjetër. Vodafone Albania dhe Altelecom janë të detyruara të shkëmbejnë trafikun ndërmjet rrjeteve përmes një interkoneksioni të drejtpërdrejtë dhe të përjashtojnë rrugëzimin e thirrjeve përmes zgjidhjeve anashkaluese/periferike, siç mund të jenë Portat-GSM apo pajisje të tjera që mund të rezultojnë në dëmtime të cilësisë, mbingarkesë të rrjetit apo probleme të sigurisë.
- Vodafone Albania dhe Altelecom sh.a duhet të respektojnë, për aq sa është teknikisht e mundur, rekomandimet përkatëse të ITU dhe udhëzimin (02)051 të ETP (European Telecom Platform) për CLI.

Gjatë gjithë procesit, KZM ka patur si qëllim të ofrojë një zgjidhje sa më të shpejtë, të sigurojë të drejtat e palëve dhe të përmbushë të gjithë objektivat rregullatorë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015) neni 33 e në vijim,

V E N D O S:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me VKD Nr.44, datë 19.6.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së “Altelecom sh.a” “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”;
3. Vodafone të marrë masat për sa parashikohet në këtë Vendim si dhe për minimizimin e mëtejshëm të trafikut të gjeneruar nga CLI brënda një afati prej 2 muajsh nga data e marrjes së këtij Vendimi.
4. Të njoftohen palët e interesuara Altelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir Zela

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI